



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:297442

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06353852

**P.nr.31/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi Mucaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L.Z, nga fshati ....., i Komunës së ....., për shkak të dy vepra penale të “Vjedhjes së rëndë” nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së si dhe veprës penale “Vjedhje e rëndë” e mbetur në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.Nr.2601/23 të datës 18.01.2024 dhe PP/II Nr. 2712/2023, e datës 12.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 05.08.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit M.M, mbrojtësit të pandehurit av.Milot Neziraj, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe të pandehurit L.Z, me datën 27.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 25.10.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**L.Z**, nga i ati L. dhe e ëma G. e gjinisë ....., i lindur me dt. .... në Pejë, me vendbanim në fsh. ...., K. ...., i identifikuar me nr. personal ....., i pamartuar, ka të kryer shkollën e ....., me profesion ....., i gjendjes së ..... ekonomike, ka qenë nën masën e paraburgimit nga data ..... e deri me datën ....., tani gjendet në paraburgim për një vepër tjetër penale.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

- Më datë 25.12.2023, rreth orës 05:00 në Pejë, në Rr “Konferenca e Bujanit” e pikërisht në ..... “.....”, me dashje e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, me forcë depërton brenda ndërtesës së sallonit të lartcekur, në atë mënyre që, i pandehuri natën kritike duke përdor një mjet te fort, me forcë arrin ta hap derën e sallonit te lartcekur duke u futur brenda nga ku ka marr para metalike në vlerë rreth 3-4 euro, ku i njëjti kapet në flagrancë nga policia,*

-Me çka ka kryer veprën penale **“Vjedhja e rëndë”** nga neni 315 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

**II.** Më datë 25.12.2023 rreth orës 04:00 në Pejë, në Rr “Adem Jashari” e pikërisht në ..... “.....”, me dashje e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, depërton me forcë brenda ndërtesës së lartcekur, në atë mënyre që, i pandehuri natën kritike me forcë hap derën e lokalit të lartcekur, duke u fut brenda, nga ku ka marrë një telefon samsung i bardh, një box muzike, një parfim, para në vlerë rreth 5 euro, si dhe pije dhe lëngje,

-Me çka ka kryer veprën penale **“Vjedhja e rëndë”** nga neni 315 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

**III.** Më datë 22.09.2023 rreth orës 04:00 në Pejë, në Rr “Vrana Konti” në Pejë e pikërisht në ..... “.....”, me dashje e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, tenton të merr pasurinë e luajtshme pronë e të dëmtuarës ..... së lartcekur, në atë mënyre që, pasi i pandehuri depërton brenda në objekt përmes dritares e cila ishte gjysmë e hapur, fillimisht kontrollon ambientin e brendshëm të shkollës, më pas shkon tek punëtorja e shkollës, ku hap derën e të njëjtës me forcë, demolon brenda, mirëpo nuk merr asgjë, e meqenëse nuk arrin të siguroj asgjë, dëmton një orman në vlerë prej 50 euro dhe largohet nga aty pa u vërejtur nga askush,

-Me këtë ka kryer veprën penale **“Vjedhja e rëndë”** e mbetur në tentativë nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72 dhe 315 par.1 pika 1.1 të KPRK-së dhe 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 par.4 dhe 460 të KPRK-së, të akuzuarit fillimisht i:

## I PËRCAKTON

Për veprën penale **“Vjedhjes së rëndë”** nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së, nga pika I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e katër (4) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro.

Për veprën penale **“Vjedhjes së rëndë”** nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së, nga pika II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e katër (4) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro.

Për veprën penale **“Vjedhje e rëndë”** e mbetur në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, nga pika III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, si dhe dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro.

Në kuptim të nenit 76 par. 1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, gjykata të pandehurin e:

## G J Y K O N

- I. **ME DËNIM UNIK ME BURGIM** në kohëzgjatje prej tri (3) vite e dy (2) muaj, e në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 25.12.2023 e deri me datën 13.02.2024, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. **ME DËNIM UNIK ME GJOBË**, në shumën prej njëmijetreqind (1300) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguaj, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.
- IV. Obligohet i akuzuari që gjykatës të ia paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë ne emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej nga njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.
- V. Të dëmtuarit M.M, nga..... rr. ".....", e dëmtuara E.K, nga fshati ..... e ..... si dhe ..... ".....", në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### Arsvetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, kundër të pandehurit L.Z, nga ....., ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2172/23 të dt.12.01.2024, për shkak të veprës penale ‘*Vjedhja e rëndë*’ e mbetur në tentativë, nga neni 315 par.1 pika 1.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, lënda në gjykatë evidentohet nën shenjën P.nr.29/24. Po ashtu, Prokuroria Themelore në Pejë, me datën 18.01.2024, kishte ngritur aktakuzën nën shenjën PP/II Nr.2601/2023, për shkak të dy vepra penale ‘*Vjedhja e rëndë*’, nga neni 315 par.1 pika 1.1 të KPRK-se. Lënda në gjykatë evidentohet nën shenjën P.nr.31/24.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pasi ka pranuar propozimin për bashkimin e procedurave gjyqësore të lëndëve aktive të të pandehurit L.Z, dhe pasi që ka gjetur së para të njëjtës gjykatë zbatohen procedurat e ndara penale kundër të pandehurit të njëjtë me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale, me dt.29.01.2023, ka marrë Aktvendim me të cilin janë bashkuar lëndët P.nr.29/24 (sipas aktakuzës PP/II Nr.2172/2023 e dt.12.01.2023) dhe P.nr.31/24 (sipas aktakuzës PP/II Nr.2601//2023 e dt.18.01.2024).

Gjykata me datën 29.01.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, e konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit Sadije Muriqi, i dëmtuari M. M, e dëmtuara E.K, i pandehuri L.Z se bashku me mbrojtësin e tij av.Milot Neziraj, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Gjykata shqyrtimin fillestar me datë 29.01.2024, i pandehuri pas njoftimit me drejtat dhe detyrimet e tij është deklaruar se e pranoj fajësinë për të gjitha veprat penale të cilat me vihen në barrë, sipas aktakuzave PP/II Nr.2601/23 të datës 18.01.2024 dhe PP/II Nr.2712/2023 dt.12.01.2024, dhe atë për dy vepra penale të ‘Vjedhjes së rëndë’ nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së dhe veprën penale ‘Vjedhje e rëndë’ e mbetur në tentativë nga neni 315 par.1 nën par. 1.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke deklaruar se me vjen keq për rastin që ka ndodhur, ju kërkoj falje të dëmtuarve, këtë pranim të fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare, pa presion nga askush, pas konsultimit me mbrojtësin.

Pas deklarimit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë me ç ‘rast, Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi, ka deklaruar se: *kërkoj nga ana e gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të vlerësoj pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana renduese mënyrën e kryerjes së veprës penale, dashjen e lartë, faktin së i njëjti sipas aktakuzave tjera i njëjti është dyshuar për veprat e njëjta penale, për të cilat edhe i pranoi fajin faktikisht.*

Mbrojtësi i të pandehurit av.Milot Neziraj ka deklaruar: *e kundërshtojmë rrethanat renduese të propozuara nga ana e prokurorisë pasi që asnjëra nga to nuk qëndrojnë e aq më pak pretendimi që i mbrojturi im është i dyshuar për rase të tjera penale, kjo për faktin së nuk ekziston asnjë aktgjykim i formës së prere ndaj tij, ndërsa si rrethana lehtësues i propozoj gjykatës që ti trajton pranimin e fajësisë, dhe ti kushtoj rendësi së një pranim i tille është bërë në të gjitha fazat e procedurës respektivisht që nga intervisitimi i parë në polici, pastaj të trajtoje edhe shprehjen e pendimit, kërkim faljen, dhe faktin së nuk është i dënuar me aktgjykime të formës së prere.*

I pandehuri L.Z, ka deklaruar se: *pajtohem me deklarimin e mbrojtësit tim, nuk kam çka të shtoj më shumë.*

Gjyqtarja e vetme gjykuese pas deklarimit të pandehurit dhe pas marrjes së mendimit të palëve në procedurë, ka Aprovuar pranimi i fajësisë nga i pandehuri L.Z, për veprën penale ‘Vjedhja e rëndë’ e mbetur në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP/II Nr. 2712/2023 dt. 12.01.2024. Ndërsa, ka Refuzuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L.Z për dy vepra penale të ‘Vjedhjes së rëndë’ nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP/II Nr. 2601/23 të datës 18.01.2024 për shkak së aktakuza përmban shkelje të qartë ligjore dhe gabime faktike sa i përket kohës së kryerjes së veprave penale.

Gjykata Themelore - Departamenti i Përgjithshëm-duke vepruar sipas aktakuzave të lartë-theksuara, lidhur me refuzimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit për *dy vepra penale të ‘Vjedhjes së rëndë’ nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së*, e sipas aktakuzës PP/II Nr. 2601/23 të datës 18.01.2024, e ka njoftuar të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij se në afat prej 30

ditëve kanë mundësi të paraqesin kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave.

Mbrojtësi dhe i pandehuri e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë, ashtu që gjykata, duke vendosur për kërkesën për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave, ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave me Aktvendimin P.nr.31/24 të datës 29.03.2024.

Aktvendimin P.nr.31/24 të dt.29.03.2024, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij e kanë ankimuar, ku në raport me ankesën e parashtruar nga i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin PN.nr.660/24, e dt.23.04.2024, e kanë refuzuar ankesën dhe vendimin e ankimuar e kanë vërtetuar.

Gjykata Themelore – Departamenti i Përgjithshëm, pasi që akti akuzues ka marrë formën e prerë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor me datën 25.09.2024, në të cilën seancë prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, para leximit të aktakuzës ka deklaruar se: në dispozitivin e parë për shkak të një lëshimi teknik përmirësohet në kohën e kryerjes, në vend të orës 04:40 duhet të jetë ora 05:00, ndërsa në pikën dy të dispozitivit përmirësohet po i njëjti lëshim teknik ku në vend të ora 7:15 duhet të jetë ora 04:00, pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Gjykata pas leximit të aktakuzës e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat, kushtet dhe privilegjet e pranimit të fajësisë dhe i cili ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije *e pranon fajësinë*, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës i vjen keq për veprimin e bërë dhe ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me aktvendim e ka aprovuar pranimin e fajësisë të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje me provat formale- materiale të bashkangjitura në aktakuzë PP/II Nr. 2712/2023 dt. 12.01.2024, siç janë: *Raporti i Oficerit, A.S #3531, të datës 22.09.2023; Raporti Informues, A.K.i #6419, të datës 22.09.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje dëshmitarin F.K, i datës 22.09.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin L.Z, i datës 30.09.2023; 5 (pesë) foto të vendit ku ka hyrë i pandehuri dhe dëmet e shkaktuara; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit në procedurë paraprake të dt. 08.11.2023, Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit në procedurë paraprake të dt. 08.11.2023; si dhe provat e cekura në aktakuzën PP/II Nr. 2601/23 të datës 18.01.2024, për të cilën i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor siç janë: *Raporti fillestar i incidentit, A.G #11408, të datës 25.12.2023; raporti i oficerit i dt. 25.12.2023, procesverbal i marrjes në pyetje i dëshmitarit, F.J i dt. 25.12.2023, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarën E.K 1 dt. 25.12.2023, fotoalbum, raporti fillestar I incidentit, G.K**

#11662, te 25.12.2023, raporti i oficerit G.K i dt. 25.12.2023, procesverbal i marrjes ne pyetje për te dëmtuarin M.M 1 dt. 25.12.2023, procesverbali i marrjes ne pyetje te dyshuarin L.Z, i datës 25.12.2023, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve i dt. 25.12.2023, vërtetim mbi kthimin e sendeve te sekuestruara, deklarata e te dëmtuarës e dhëne ne prokurori me date 11.01.2024, deklarata e te dëmtuarit e dhënë në prokurori me date 11.01.2024, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 322 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 241 par.4 të KPPRK-së, si dhe pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit, konform nenin 356 par.1 i KPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me fjalën përfundimtare dhe shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se: *meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë qysh në fillim të seancës se shqyrtimit gjyqësor, pranim ky i cili u miratua edhe nga gjykata bazuar edhe ne provat e bashkangjitura në aktakuzë konsideroj se mbetet e pa kontestueshme gjendja faktik e përshkruar si në dispozitiv e aktakuzës e cila gjene te pandehurin penalisht përgjegjës, për dy vepra penale 'Vjedhje e rëndë' nga neni 315 par.1 pika 1.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082, për çka kërkoj nga gjykata qe ndaj et pandehurit te shpall aktgjykim fajësues ku d ti shqiptoj një dënim meritior brenda kufjeve te përcaktuar me ligj, kurse me rastin e matës se dënimit i propozoj qe si rrethanë renduese te merr parasysh faktin se veprat penale te cilat i pandehuri u deklaruar fajtor tregojnë për një recidivizëm special e po ashtu te marr parasysh dënimet eventuale te mëparshme ndaj te pandehurit, kurse si rrethanë lehtësuese te merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit.*

I dëmtuari M.M, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: *pajtohem me deklarimin e prokurorit te shtetit, unë kërkoj dëmshpërblimin qe me është shkaktuar, përndryshe ia le ne vlerësim gjykatës.*

Mbrojtësi i të pandehurit av.Milot Neziraj, ka deklaruar se: *fillimisht i kundërshtojmë pretendimet e prokurorisë kur përmendet se mbrojturi im është i përfshirë ne recidivizëm special, duke qene se nuk u prezantua ndonjë aktgjykim i formës se prere qe ky te jete i dënuar më pare për ndonjë vepër te natyrës se njëjtë kurse ne anën tjetër i propozoj gjykatës qe si rrethanë lehtësuese te trajtoj pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im dhe me rëndësi te veçantë ti kushtohet faktin se një pranim i tillë është bere ne fazën e mëhershme te procedurës respektivisht më rastin e intervistimit në polici, pasur në intervistimin në prokurori e pa ashtu dhe ne shqyrtimit fillestar te dt.12.02.2024, te trajtohen si rrethana lehtësuese edhe keqardhja e shprehur dhe kërkim falja ndaj palëve te dëmtuar M.M dhe E.K e cila kërkim falje është pranuar edhe nga këta te fundit ne seancën e dt.12.02.2024. ne vazhdimësi kemi theksuar dhe kërkuar qe veprimet inkriminuese të të mbrojturit tim për te cilat edhe e pranoj fajësinë te konsiderohen si një vepër penale e kryer ne vazhdimësi meqenëse plotësohen te paktën tri nga kushtet e përcaktuara me nenin 77 par.1 të KPRK-së, respektivisht shfrytëzimi i situatës së njëjtë kohore, hapësirë e njëjtë e kryerjes se veprës penale dhe dashja e kryerësit.*

I pandehuri L.Z, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: *jam i penduar i kërkoj falje të dëmtuarit gjykatës dhe premtoj që sdo të përsëris me vepra të tilla.*

Andaj, me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e dy veprave penale “*Vjedhjes së rëndë*” nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së si dhe veprën penale “*Vjedhje e rëndë*” e mbetur në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur së të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë që do te ishte me ndikim për zvogëlimin apo përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit L.Z, prandaj i njëjti është penalisht përgjegjës dhe shpallet fajtor për veprat penale si në dispozitivat I, II dhe III të këtij aktgjykimi.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, për të akuzuarin L.Z.

Gjykata në rastin konkret për të pandehurin e lartcekur si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e tij të fajësisë dhe shprehjen e keqardhjes pranë gjykatës për veprat e kryera penale, si dhe moshën e tij relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale.

Në anën tjetër, si rrethana rënduese gjykata mori parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, dashjen e lartë dhe këmbënguljen e kryesit për të kryer veprat penale, te manifestuar përmes veprimeve të vazhdueshme të tij, tek i njëjti gjeti rrezikshmërinë e lartë shoqërore në kryerjen e veprave penale, po ashtu edhe motivi i kryerjes së veprave penale ka qenë motivi financiar, se i akuzuari në veprimet e tij nuk ka kursyer asgjë në drejtim të kryerjes së veprës penale, respektivisht motivi financiar i tij i kryerjes së veprës penale ka qenë primar në raport me interesin e përgjithshëm, ku pa mëdyshje e ka ditur se veprimet e tij janë të kundërligjshme (përbëjnë vepër penale), mirëpo motivi i tij i përfitimit material i ka tejkalluar ato, po ashtu gjykata si rrethanë rënduese mori parasysh edhe dënimet e tij të mëparshme penale dhe posaçërisht faktin se i njëjti është dënuar për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe atë me Aktgjykimin e plotfuqishme të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë P.nr.1058/23, i datës 29.02.2024, i plotfuqishëm me datën 16.04.2024, më të cilin i pandehuri është dënuar me dënim më burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 1 viti e të cilin dënim nuk do të ekzekuton nëse brenda periudhës prej 2 vitesh i pandehuri nuk do të kryej vepër tjetër penale, si dhe me dënim me gjobë në shumën prej 500 euro, për veprën penale “*Vjedhje*” nga neni 313 par.1 të KPRK-së, që si rrjedhojë vërehet se nuk është arritur qëllimi i dënimit

lidhur me rehabilitimin e tij gjë që e bëjnë të njëjtin recidivist të veprave penale kundër pasurisë. Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se me këtë dënim të shqiptuar, do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahet nga këto veprime/kryerja e veprës-veprave penale të këtilla.

Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprave penale të cilat i ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të kryej veprime të ndaluara - përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprat e kryera penale, të bëj ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 315 par.1 nën par 1.1 dhe nenin 315 par.1 nën par 1.1 e lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) që e përcakton veprën penale dhe dënimin për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor të pandehurin.

Neni 315 par.1 i KPRK-së përcakton minimumin dhe maksimumin e dënimit, dënim me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej tri (3) vitesh e dy (2) muajsh për të pandehurin u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale “Vjedhje e rëndë” nga neni 315 par.1 nën par 1.1 të KPRK-së është dënimi prej pesë (5) vjetësh burgim<sup>1</sup>. Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke zbatuar nenin 71 pika 1.3 të KPRK-së i cili përcakton se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “*në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë*” dhe nenin 72 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale për të gjitha veprat penale, andaj mbi këtë fakt gjykata pranimin e fajësisë e mori si bazë për zbutjen e dënimit.

<sup>1</sup> Udhëzues për Politiken Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 101.



Zbutja e dënimit u bë në kuadër të mundësive të përcaktuara më ligj, pasi që neni 72 par 3 pika 3 ka paraparë *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”*.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha të sipërsëhënuarat, gjykata fillimisht të pandehurit i shqiptoi dënimet për veprat penale për të cilat akuzohet secilën veç e veç, nga neni 315 par.1 nen par.1.1 dhe 315 par.1 nen par.1.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ndërsa pastaj në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPRK-së, i shqiptoi dënimin e unifikuar me burgim në të cilin dënim i është llogaritur konform nenit 79 par. 1 të KPRK-së, i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 25.12.2023 e deri me datën 13.02.2024, si dhe iu shqiptoi dënimet unike me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast së i pandehura dështon, refuzon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par.1 dhe par. 2 dhe nenit 452 par. 1 të KPPRK-së, e ngarkoi të pandehurin me shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar prej fillimit të kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, e po ashtu konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilat obligohet ti paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit M.M, E.K, nga fshati ..... e ..... dhe ..... ".....", ne ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 457 dhe nenit 462 par.2 të KPPRK-së, andaj gjykata ka vendosur si në pikën e VI të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.31/24, me datë 25.10.2024.**

**Bashkëpunëtore profesionale:**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese:**

\_\_\_\_\_  
**Leonita Lajqi Muçaj**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KELMENDI**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.